



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VLORË  
DREJTORIA E PËRGJITHSHME RREGULLATORE  
DREJTORIA E BASHKËQEVERISJES  
SEKTORI I MENAXHIMIT TË E-KËRKESAVE DHE E-ANKESAVE

Nr. 3828 prot.

Vlorë, më 24.02.2026

PROCESVERBAL KONSULTIMI PUBLIK

DATË 20.02.2026 ORA 13:30

**Tema:** Konsultim publik për miratimin e tarifës së shërbimit të karrotrecit për çdo mjet, si dhe tarifat ditore për qëndrimin e automjeteve në pikat e bllokimit të Policisë Bashkiake në territorin e Bashkisë Vlorë.

**Baza ligjore:** Në zbatim të ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” neni 18; ligjit nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit”, ligjit nr.146/2014 “Për njoftimin dhe konsultimin publik” pika 1 dhe 2 neni 5, pika 1,2,3 neni 52; Rregullores e Organizimit dhe Funksionimit të Bashkisë.

**Marrin pjesë:**

*Nënkryetar i Bashkisë – z. Ilir Hasani, Nënkryetarja e Bashkisë – znj. Klea Lalo, Kryetarët e Rajonove, Drejtor i Ploicisë Bashkiake- z. Taulant Kondi, Përgjegjëse Sektori- znj. Rudina Mehmeti, anëtar të këshillit bashkiak, drejtorë të Administratës së bashkisë Vlorë, përfaqësues nga komuniteti, përfaqësues nga biznesi.*

**Takimin e hapi Nënkryetar i Bashkisë Vlorë- z. Ilir Hasani:** Përshëndetje, kjo dëgjese organizohet për miratimin e tarifës së shërbimit të karrotrecit për çdo mjet, si dhe të tarifave ditore për qëndrimin e automjeteve në pikat e bllokimit të Policisë Bashkiake.

Tarifat e propozuara janë në përputhje me parimin e proporcionalitetit dhe përballueshmërisë, si dhe kanë funksion parandalues për respektimin e rregullave të parkimit dhe qarkullimit rrugor në territorin e Bashkisë Vlorë.

Përcaktimi i tarifës ditore për qëndrimin e automjeteve në pikat e bllokimit, në masën 500 lekë për çdo 24 orë qëndrimi, është bërë duke u bazuar në analizën e kostove reale të shërbimit, të cilat përfshijnë shpenzimet për personelin e angazhuar, shpenzimet administrative, si dhe garantimin e vazhdimësisë së shërbimit.

Miratimi i këtyre tarifave synon përmirësimin e qarkullimit rrugor, rritjen e sigurisë publike, menaxhimin e rregullt të hapësirave publike, si dhe ofrimin e një shërbimi efikas dhe të qëndrueshëm nga Bashkia Vlorë.



**Z. Endri Hyseni, Këshilltar:** Ku do të jetë vendqëndrimi i automjeteve?

**Z.Taulant Kondaj, Drejtor i Policisë Bashkiake:** Për pikën e grumbullimit nuk është përcaktuar ende vendi. Kërkohej bashkëpunim i ngushtë me Policinë dhe strukturat e tjera përkatëse. Do të përpiqemi që të jetë sa më afër dhe parkimi do të jetë shtetëror.

**Z.Iliri Hasani, Nënkryetar i Bashkisë Vlorë:** Është më se i domosdoshëm shërbimi i karrotrecit. Kemi shumë ankesa nga qytetarët për zënien e hapësirave publike nga mjetet e parkuara për periudha të gjata kohore. Ky shërbim do të ndikojë në lirimin e hapësirave, përmirësimin e qarkullimit dhe rritjen e sigurisë në qytet.

**Z.Taulant Kondaj:** Kjo përbën një zgjidhje edhe në situata fatkeqësish natyrore apo kur mjetet kanë vështirësi në lëvizje për shkak të defekteve teknike.

**Z. Erjon Vangjeli:** Doja të shtoja diçka lidhur me tarifën e shërbimit prej 4 000 lekësh që është vendosur. Gjatë sezonit, Policia Bashkiake mbulon edhe zonën e Orikumit, ndaj tarifa e shërbimit duhet të përcaktohet sipas distancës dhe jo të jetë e njëjtë për largësi të ndryshme.

Gjithashtu, firmat që po operojnë në qytet nuk vendosin sinjalistikën e nevojshme për kryerjen e punimeve. Është e domosdoshme që sinjalistika të vendoset disa ditë përpara nisjes së punimeve, pasi mungesa e saj krijon probleme dhe vështirësi për qarkullimin e automjeteve.

**Z.Taulant Kondaj:** Duhet të njihemi me punimet në qytet dhe ndikimin e tyre tek qytetarët, duke kërkuar informacion të qartë dhe të rregullt nga institucionet përgjegjëse.

**Z. Hamet Rapaj, banor në lagjen “Hajro Cakerri”,** pranë Shkollës “28 Nëntori.

Dua të njoftoj për disa probleme që po ndikojnë në sigurinë dhe qetësinë e banorëve:

- Biznese të vogla që pengojnë qarkullimin: Ka biznese të vogla, si pika shërbimesh, që vendosin aktivitetin e tyre në rrugë dhe pengojnë kalimin e automjeteve. Kjo krijon bllokime dhe rrit rrezikun për aksidente. Mendoj se në lagje nuk duhet të ekzistojnë biznese që ndërhyjnë në rrjedhën normale të trafikut.

- Mungesa e sinjalistikës dhe shpejtësia e automjeteve: Në rrugët e lagjes nuk ka sinjalistikë të mjaftueshme, ndërkohë që disa makina lëvizin me shpejtësi të lartë. Kjo përbën një rrezik të madh, veçanërisht për fëmijët dhe këmbësorët.

Ju lutem të merrni masat për vendosjen e sinjalistikës dhe kontrollin e bizneseve që pengojnë qarkullimin në rrugët e brendshme të lagjes.

Faleminderit për vëmendjen!

**Z. Iliri Hasani:** E kuptoj shqetësimin tuaj lidhur me bizneset. Kjo është më shumë një çështje e vendimmarrjes ligjore sesa e pushtetit vendor. Do ta shqyrtojmë këtë problematikë brenda kuadrit ligjor.”

Faleminderit!

Koordinatorë për Njoftim dhe Konsultim Publik

Aurora Kamberaj